



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E STREHIMIT

Nr. 657 / Prot.

Tiranë, më 14/1 /2021

Lënda: Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021

BASHKISË _____

Nëpërmjet kësaj shkrese ju bëjmë me dije mbi fondet e planifikuara për projektet e strehimit për vitin 2021, si edhe ju informojmë mbi afatet dhe mënyrën e aplikimit për përfitimin e tyre.

Buxheti i shtetit për projektet e investimeve në strehim për vitin 2021 është 300 milion lekë në total, nga të cilat 140 milion lekë do të përdoren për financimin e projekteve në vazhdim nga viti 2020 dhe 160 milion lekë janë planifikuar për projektet e reja të strehimit.

Ndarja dhe përdorimi i fondeve buxhetore për projektet e strehimit në vitin 2021 do të synojë:

- zgjerimin e impaktit të projekteve të investimeve jo vetëm tek familjet që përfitojnë, por për të gjithë zonën ku bëhet ndërhyrja;
- rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve duke i përqëndruar në një territor të njësisë së vetëqeverisjes vendore (kryesisht në rastin e projekteve të përmirësimit të kushteve të banesave);
- angazhimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke rritur kontributin e përgjithshëm në bashkëfinancimin e strehimit;
- koordinimin e programeve/ projekteve të strehimit me programe të tjera (p.sh.: investime në infrastrukturë, shërbime sociale, punësimi, aftësimi profesional, etj.) që financohen nga donatorë apo institucione të tjera.

Aplikimi për përfitimin e fondeve do të bëhet me procedurë konkurrimi. Informacioni i plotë mbi llojin e projekteve që do të financohen, kushtet për të përfituar fonde, formatin e aplikimit dhe kriteret e vlerësimit të projekteve të reja të investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2021, është përmbledhur në Shtojcën "A, publikuar në faqen e Ministrisë, në adresën: <http://financa.gov.al/drejtoria-e-strehimit/>.

Afati i dorëzimit të aplikimeve për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për projektet e strehimit është **data 15.03.2021**.

Informojmë se për bashkitë, të cilat do të shpallen fituese për projektet e investimit të vitit 2021, fondet e buxhetit të shtetit do të çelen, vetëm pasi të jenë çelur fillimisht fondet e bashkëfinancimit nga njësitet e vetëqeverisjes vendore.

Çdo kursim nga prokurimi do të ndahet sipas përqindjes së bashkëfinancimit dhe fondi i kursyer nga buxheti i shtetit do t'i kthehet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për çdo pyetje a sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresat e email-it: Mimoza.Kondili@financa.gov.al dhe Visiana.Shamo@financa.gov.al.

